



## Studim Hulumtues

TEMA: Rënia e nivelit të Arsimit

Orientimi i të rinjëve vetëm në një numër të kufizuar departamentesh

Gresa T. Deda

## Hyrje

*“Arsimi është arma më e fuqishme e cila përdoret për ta ndryshuar botën” – Nelson Mandela*

Në kohën kur bota po ndryshon me shpejtësi marramendëse duke prodhuar dhe konsumuar dituri të re, rinia jonë vazhdon të qëndrojë jashtë këtij procesi dhe në izolim. Me një realitet të tillë përballen studentët e vendit tonë, të cilët pas diplomimit nuk kanë një përgaditje të mirë akademike që të jenë në një nivel me studentët e botës. Rezultat i kësaj është menaxhimi joefektiv i institucioneve udhëheqëse ndaj arsimit.

Qëllimi i këtij studimi është që Ministria e Arsimit dhe Rektorati të shohin përtej fushës së tyre të ngushtë. Të shohin gjendjen e arsimit që është prezente në Universitetin e Prishtinës i cili është duke shkuar dita e ditës drejt dështimit, ashtu që t’i ndërmarrin masat e nevojshme rreth kësaj çështje shumë të rëndësishme.

## Përmbajtja

Arsimi është një ndër shtyllat kryesore për një shoqëri të shëndosh, për një zhvillim të gjithanshëm të një vendi dhe një ngritje kulturore të asaj shoqërie kompakte. Kjo na bënë të kuptojmë që arsimit qenka baza e qdo gjëje të mirë, të shëndosh dhe të vlefshme. Andaj, është mëkat që ne si shoqëri të mos kontribuojmë në këtë aspekt. Kontributin mund ta japim në çfarëdo llojë mënyre vetëm duhet të kemi dëshirë dhe vullnet për ta bërë një gjë të tillë sepse po i patëm këto të dyja, barrierat tjera as që do i shohim e lëre më të na pengojnë. Kontributin më të madh në arsimimin e një shoqërie padyshim se e japin institucionet shkollore, duke filluar nga ato të arsimit të ulët, të mesëm e deri te institucionet e arsimit të lartë në kuadër të së cilave hyjnë universitetet shtetërore dhe ato private.

Edhe pse kontributin më të madh po e japin institucionet shkollore për zhvillimin e arsimit në një shoqëri, por prapë prap po ka probleme serioze sidomos në arsimin

universitar: siç është shtimi i madh i Bartësve Privatë të Arsimit të lartë, ku ekzistojnë 30 institucione të arsimit të lartë privat në Kosovë.<sup>1</sup> Profilizimi i tyre po bëhet konform kërkesave të tregut të punës dhe ngritja e cilësisë duhet të jetë prioritet i tyre, por edhe i autoriteteve përgjegjëse të kësaj fushe. Problem tjetër është edhe nxerrja në pah e korrupsionit, ryshfetit në UP që po ndodh kohët e fundit. Ku Policia e Kosovës dhe Prokuroria kanë filluar aksionin për zbardhjen e mashtremeve që kanë ndodhur për regjistrimin e studentëve në Fakultetin e Mjekësisë, ku individët e caktuar për regjistrimin e studentëve në këtë fakultet si këmbim kanë marr shumën të majme prej 4 mijë deri në 10 mijë euro.<sup>2</sup> Eksperti kosovar i çështjeve të arsimit, Dukagjin Popovci thotë: Imazhi i UP'së tashmë është i dëmtuar rëndë. Nuk është normale që në një universitet të shiten nota, të shiten vende për regjistrim të brucoshëve të rinj e kështu me radhë. Ndërmarrja e masave tjera i takon organeve të drejtësisë. Me siguri që nuk mjafton të mbetet puna vetëm me shkarkime e suspendime sepse këtu ka edhe njerëz tjerë përgjegjës”, thotë Dukagjin Popovci.<sup>3</sup>

Të gjitha këto probleme po ndikojnë që Kosova të mos renditet më lartë në ranglistat ndërkombëtare për arsim.<sup>4</sup> Arsimi kosovar sipas ranglistave ndërkombëtare për këtë vit renditet e 4,416-ta<sup>5</sup>, në krahasim me vitin e kaluar bie për 1,030 vende më poshtë për cilësi.<sup>6</sup> Nga ky rezultat po vërehen prioritetet që kjo qeveri ka ndaj arsimit. Politikanët shpesh flasin për vlerën e madhe të rinisë që disponon Kosova. Kjo është e vërtetë për Kosovën duke pasur parasysh që ka popullësinë më të re në Evropë. Por duhet ditur një gjë që rinia ka vlerë vetëm nëse është e arsimuar, përndryshe ajo është një barrë.

---

<sup>1</sup> “Arsimi i lartë në Kosovë dhe sfidat e reformimit”, Telegrafi, 23 shkurt 2010 <http://www.telegrafi.com/lajme/arsimi-i-larte-ne-kosove-dhe-sfidat-e-reformimit-26-2211.html> qasur më 7 qeshor 2013

<sup>2</sup> “Edhe Mujë Rugova I dyshuar për korrupsion në Fakultetin e Mjekësisë”, Express, 12 Dhjetor 2013, <http://www.gazetaexpress.com/?cid=1,15,128899> qasur më 20 Dhjetor 2013

<sup>3</sup> “Hetoni deri në fund”, Lajmi, 19 Dhjetor 2013, <http://lajmi.net/hetoni-deri-ne-fund/> qasur më 19 Dhjetor 2013

<sup>4</sup> Kosova sipas ranglistave ndërkombëtare për vitin 2012 renditet e 3386-ta, “Arsimi i lartë dhe politizimi”, Telegrafi, 5 janar 2013 <http://www.telegrafi.com/lajme/arsimi-i-larte-dhe-politizimi-26-5587.html> qasur më 10 qeshor 2013

<sup>5</sup> “Ranking web of universities”, 2013, <http://www.webometrics.info/en/Europe?page=12>

<sup>6</sup> “Ranking web of universities”, 2013, <http://www.webometrics.info/en/Europe?page=12>

Meqenëse gjatë viteve të fundit është vërejtur një numër i shtuar i të rinjëve të cilët orientohen në një numër të kufizuar të departamenteve, ndërsa disa fusha të tjera janë shumë më pak të përzgjedhura nga ta, madje ka edhe mungesë të të interesuarve për ato fusha.

Universiteti i Prishtinës pranon çdo vitë nga 47.000 studentë.<sup>7</sup> Në fushën e ekonomisë i vijnë studimet 30% e studentëve, ndërsa 14.6% janë student të juridikut, shkencave politike, administratë publike etj, kurse në sektorin privat 62.4% e studentëve studiojnë ekonominë.<sup>8</sup> Njëra prej arsyeve se pse studentët preferojnë këto fusha studimi është se sektori më i madh i punësimit në Kosovë është sektori publik dhe personat më të kërkuar për të punuar në këtë sektor janë ekonomistët, juristët dhe politikologët.<sup>9</sup> Kjo rritje e shpejtë e numrit të studentëve sjell probleme për të ofruar një edukim kualitativ. Prandaj cilësia e saj është e ulët, këtë e tregojnë raportet e fakulteteve, mbase për shkak të rritjes së shpejtë të numrit të studentëve.<sup>10</sup>

Drejtori i institutit për Hulumtime të Avancuara, Agron Demi thotë “Pavarësisht asaj se mbi 60000 studentë për çdo vit janë pjesë e Universiteteve, qoftë publike apo private, niveli apo shkathtësitë që ata fitojnë, nuk janë të përshtatshme për tregun e punës në vitin 2013, apo viteve tjera për shkak se prurjet e reja teknologjike dhe metodat e reja të punës, janë shkathtësi, të cilat universitetet tona nuk po ua mësojnë studentëve”. Në një vend si Kosova që ka 47% papunësi dhe në anën tjetër bizneset nuk arrijnë të gjejnë forca kualifikuese punëtore, konsiderohet papunësi strukturale, ku edhe bizneset nuk arrijnë të

---

<sup>7</sup> “Arsimi – çelësi i ardhmërisë së Kosovës”, Zëri, 30 mars 2013 <http://www.zeri.info/artikulli/2918/arsimi-celesi-i-ardhmerise-se-kosoves> qasur më 6 korrik 2013

<sup>8</sup> “A ndikon ngritja e cilësisë së arsimit të lartë në rritjen e zhvillimit ekonomik apo zhvillimi ekonomik ndikon në ngritje të arsimit të lartë?”, Demokraci për zhvillim, 11 tetor 2011 <http://d4d-ks.org/editorialet/a-ndikon-ngritja-e-cilesise-se-arsimit-te-larte-ne-rritjen-e-zhvillimit-ekonomik-apo-zhvillimi-ekonomik-ndikon-ne-ngritje-te-arsimit-te-larte-2/> qasur më 7 korrik 2013

<sup>9</sup> “A ndikon ngritja e cilësisë së arsimit të lartë në rritjen e zhvillimit ekonomik apo zhvillimi ekonomik ndikon në ngritje të arsimit të lartë?”, Demokraci për zhvillim, 11 tetor 2011 <http://d4d-ks.org/editorialet/a-ndikon-ngritja-e-cilesise-se-arsimit-te-larte-ne-rritjen-e-zhvillimit-ekonomik-apo-zhvillimi-ekonomik-ndikon-ne-ngritje-te-arsimit-te-larte-2/> qasur më 7 korrik 2013

<sup>10</sup> “Arsimi – çelësi i ardhmërisë së Kosovës”, Zëri, 30 mars 2013 <http://www.zeri.info/artikulli/2918/arsimi-celesi-i-ardhmerise-se-kosoves> qasur më 6 korrik 2013

gjejnë njerëz të kualifikuarë, por edhe ata që diplomohen dhe mendojnë se janë të kualifikuar, nuk arrijnë të gjejnë punë.<sup>11</sup> Pra, në vendin tonë 25,000 të rinj për çdo vit janë të gatshëm për punë, kurse në anën tjetër, zhvillimi ekonomik me një rritje prej 3-4% është i pamjaftueshëm për të absorbuar tërë këtë fuqi punëtore. Për të përgjysmuar vetëm papunësinë, Kosovës i nevojitet një rritje ekonomike prej 10% në vit për dhjetë vitet e ardhshme.<sup>12</sup>

Dukuri mjaft shqetësues po del të jetë edhe numri i madh i studentëve të diplomuar, pavarësisht kësaj ata nuk janë të përgaditur për tregun e punës.<sup>13</sup> Që studentët të jenë të përgaditur për tregun e punës atyre përveq anës teorike duhet të ju mundësohet praktika, ashtu që ata të lidhin anën teorike me atë praktike. Arsimi i lartë nuk është i fokusuar në transmetimin e njohurive, por vetëm në dhënie diplomash. Pra në një situatë të tillë individët synojnë të krahasohen vetëm në bazë të diplomave që zotërojnë dhe jo në bazë të aftësive që ata kanë.

Zhvillimi i Kosovës varet nga cilësia dhe përfshirja e të rinjve në arsim. Sistemi arsimor duhet riorientuar drejt zhvillimit të mendimit kritik dhe shkathësive të kërkuara nga tregu i punës.<sup>14</sup> Në një shtet të vogël si Kosova potenciali njerëzor është kapitali kryesor i zhvillimit, prandaj përqendrimi në edukim dhe reformimi i sistemit akademik në Kosovë nuk duhet të jetë zgjedhje, por duhet të jetë domosdoshmëri.<sup>15</sup> Ku, përgatitja e mirë arsimore, mund të jetë një pasuri në zhvillimin e ekonomisë dhe rregullimit të imazhit të

---

<sup>11</sup> "Njerëz me diploma, port ë papërgaditur për punë", BotaSot, 16 qeshor 2013

<http://www.botasot.info/kosova/227794/njerez-me-diploma-por-te-papergatitur-per-pune/> qasur më 14 korrik 2013

<sup>12</sup> "A ndikon ngritja e cilësisë së arsimit të lartë në rritjen e zhvillimit ekonomik apo zhvillimi ekonomik ndikon në ngritje të arsimit të lartë?", Demokraci për zhvillim, 11 tetor 2011 <http://d4d-ks.org/editorialet/a-ndikon-ngritja-e-cilesise-se-arsimit-te-larte-ne-rritjen-e-zhvillimit-ekonomik-apo-zhvillimi-ekonomik-ndikon-ne-ngritje-te-arsimit-te-larte-2/> qasur më 7 korrik 2013

<sup>13</sup> "Njerëz me diploma, port ë papërgaditur për punë", Bota Sot, 16 Qeshor 2013,

<http://www.botasot.info/kosova/227794/njerez-me-diploma-por-te-papergatitur-per-pune/> qasur me 1 Shtator 2013

<sup>14</sup> "S'ka zhvillim pa zhvillim njerëzor", Shqip, 29 Korrik 2013 <http://gazeta-shqip.com/lajme/2013/07/29/ska-zhvillim-pa-zhvillim-njerezor-agon-maliqi/> qasur më 30 Korrik 2013

<sup>15</sup> "Arsimimi është politika më e mire për të rinjet e Kosovës", GazetaDitore, 19 Janar 2013

<http://gazetaditore.com/2013/01/19/arsimimi-eshte-politika-me-e-mire-per-te-rinjet-e-kosoves/> qasur më 28 gusht 2013

Kosovës si anëtare potenciale në rrugën e BE-së.<sup>16</sup> Pra, rritja e investimeve në arsim është sfida më e rëndësishme që duhet ta përballojë ekonomia dhe shoqëria kosovare. Me anë të investimeve mund të vihen bazat e një sistemi modern të arsimit, i aftë të përballojë sfidat e ekonomisë së diturisë, globalizimit dhe zhvillimeve të hovshme teknologjike.

## Përmbyllje

Në kohën kur bota po ndryshon me shpejtësi marramendëse duke prodhuar dhe konsumuar dituri të re, rinia jonë vazhdon të qëndrojë jashtë këtij procesi dhe në izolim. Me një realitet të tillë përballen studentët e vendit tonë, të cilët pas diplomimit nuk kanë një përgatitje të mirë akademike që të jenë në një nivel me studentët e botës. Rezultat i kësaj është menaxhimi joefektiv i institucioneve udhëheqëse ndaj arsimit. Andaj, në fund pasi që arsimi është arma më e fuqishme për të ndryshuar çdo gjë madje edhe botën, institucionet udhëheqëse, duhet të përkushtohen për avancimin e arsimit në vend, sepse kjo gjendje e rëndë e arsimit në Kosovë, sfidon të ardhmën e një zhvillimi ekonomik dhe demokratik të një vendi me pretendime për integritime evropiane.

Arsimi i lartë në Kosovë tradicionalisht ka qenë promotor i zhvillimit kulturor, shoqëror dhe ekonomik të vendit, por kjo në ditët e sotme nuk mund të promovohet me numrin e të diplomuarve, të magjistruarëve dhe të doktoruarve.

---

<sup>16</sup> “Arsimi – çelësi i ardhmërisë së Kosovës”, Zëri, 30 mars 2013 <http://www.zeri.info/artikulli/2918/arsimi-celesi-i-ardhmerise-se-kosoves> qasur më 6 korrik 2013

## Referencat

2. “Arsimi i lartë në Kosovë dhe sfidat e reformimit”, Telegrafi, 23 shkurt 2010 <http://www.telegrafi.com/lajme/arsimi-i-larte-ne-kosove-dhe-sfidat-e-reformimit-26-2211.html> qasur më 7 qeshor 2013
3. “ Edhe Mujë Rugova l dyshuar për korrupsion në Fakultetin e Mjekësisë”, Express, 12 Dhjetor 2013, <http://www.gazetaexpress.com/?cid=1,15,128899> qasur më 20 Dhjetor 2013
4. “ Hetoni deri në fund”, Lajmi, 19 Dhjetor 2013, <http://lajmi.net/hetoni-deri-ne-fund/> qasur me 19 Dhjetor 2013
5. Kosova sipas ranglistave ndërkombëtare për vitin 2012 renditet e 3386-ta, “Arsimi i lartë dhe politizimi”, Telegrafi, 5 janar 2013 <http://www.telegrafi.com/lajme/arsimi-i-larte-dhe-politizimi-26-5587.html> qasur më 10 qeshor 2013
6. “ Ranking web of universities”, 2013, <http://www.webometrics.info/en/Europe?page=12>
7. “Arsimi – çelësi i ardhmërisë së Kosovës”, Zëri, 30 mars 2013 <http://www.zeri.info/artikulli/2918/arsimi-celesi-i-ardhmerise-se-kosoves> qasur më 6 korrik 2013
8. “A ndikon ngritja e cilësisë së arsimit të lartë në rritjen e zhvillimit ekonomik apo zhvillimi ekonomik ndikon në ngritje të arsimit të lartë?”, Demokraci për zhvillim, 11 tetor 2011 <http://d4d-ks.org/editorialet/a-ndikon-ngritja-e-cilesise-se-arsimit-te-larte-ne-rritjen-e-zhvillimit-ekonomik-apo-zhvillimi-ekonomik-ndikon-ne-ngritje-te-arsimit-te-larte-2/> qasur më 7 korrik 2013
9. “Njerëz me diploma, port ë papërgaditur për punë”, BotaSot, 16 qeshor 2013 <http://www.botasot.info/kosova/227794/njerez-me-diploma-por-te-papergatitur-per-pune/> qasur më 14 korrik 2013
10. “ S’ka zhvillim pa zhvillim njerëzor”, Shqip, 29 Korrik 2013 <http://gazeta-shqip.com/lajme/2013/07/29/ska-zhvillim-pa-zhvillim-njerezor-agon-maliqi/> qasur më 30 Korrik 2013
11. “Arsimimi është politika më e mire për të rinjet e Kosovës”, GazetaDitore, 19 Janar 2013 <http://gazetaditore.com/2013/01/19/arsimimi-eshte-politika-me-e-mire-per-te-rinjet-e-kosoves/> qasur më 28 gusht 2013

Gresa T. Deda e autorizon KIPRED-in për publikim të temës: Rënia e nivelit të Arsimit